

UNIVERSITETI I TETOVËS



FAKULTETI FILOLOGJIK STUDIMET E DOKTORATURËS DREJTIMI: GJERMANISTIK

Deri te:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, me nr 18-159/1, nga mbledhja e mbajtur në datën 27.12.2019, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull **REFLEKTIMI KULTUROR NË MËSIMDHËNIEN E GJERMANISHTES SI GJUHË E HUAJ. Analizë e teksteve mësimore në sistemin shkollor në Maqedoni (Kulturreflexives Lernen im Deutsch-als-Fremdsprache-Unterricht. Analyse von Lehrwerken im Schulbereich in Mazedonien)**, të kandidatit z. Shadan Ramadani, Komisioni në përbërje të: Prof. dr. Arbër Çeliku, kryetar, Prof. dr. Beate Henn-Memmesheimer, udhëheqëse, Prof. dr. Brikena Kadzadej, anëtare, Prof. dr. Lulzime Kamberi, anëtare dhe Prof. dr. Berton Sulejmani, anëtar, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik i paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e punimit të doktoraturës

Z. Shadan Ramadani, i lindur në f. Përshëfcë të Tetovës, ku ka përfunduar shkollën fillore dhe atë të mesme, i diplomuar në Fakultetin Filologjik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, drejtimi profesional: Gjuhë dhe letërsi gjermane. Masterin për studime gjermane e ka përfunduar në Universitetin e Evropës Juglindore, SEEU. Të dyja këto studime i ka përfunduar me rezultate të larta. Gjatë kësaj periudhe e deri më tani ka një përvojë kryesisht profesionale dhe shkencore, të lidhur ngushtë me fushën e studimit. Prej vitit 2014 është ligjërues në degën e gjermanishtes.

Më poshtë arrijtjet e deritanishëm shkencore, referimet dhe artikujt të z. Shadan Ramadani:

Pjesëmarrje në Konferenca ndërkombëtare

- Pjesëmarrje në Konferencën e IX. Ndërkombëtare të Albanologjisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, më 01-02.10.2015, me temë: „Emigrantët shqiptarë në vendet gjermanishtfolëse si krijues letrarë dhe urëlidhëse kulturash“. Me abstrakt.
- Pjesëmarrje në Konferencën e IX. Ndërkombëtare të Germanistikës në Tiranë me 5. 06. 2015, me temë: „Die Merkmale der Literatur der Wende bei Albanischen Autoren (Tiparet e letërsisë së kthesës tek autorët shqiptarë)“. Me abstrakt.
- Pjesëmarrje në Workshop – Referat për zgjerim të kompetencës metodiko-didaktike: „Kooperatives Lernen mit Sicher* und ‚Beweg dich‘, me 19.02.2016 te EDUCATIONAL CENTRE Prishtinë.
- Pjesëmarrje në Konferencën e III. Internatioanl Congress of Teaching Turkich as a foreign language Univesity of Tirana & Sakarya Universtiy në Tiranë me 19-21. 05. 2017, me temë: „Reflektimi ndërkulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj: Analizë e teksteve mësimore (The intercultural reflection in lecturing German as a foreign language: Analysis of textbooks)“. Me abstract.

Publikime në revista ndërkombtare

-Shadan Ramadani (2017): Rezeptionsmöglichkeiten der albanischen AutorInnen in der Öffentlichkeit, die Literaturwettbewerbe und die Suche nach dem Publikum im deutschsprachigen Raum (Mundësitë e receptimit të autorëve shqiptarë në publik, konkurenca dhe kërkimi i publikut në vendet gjermanisht-folëse). Në: Dituria 11 Zeitschrift für Germanistische Sprach- und Literaturwissenschaft. Oberhausen: Athena. Editors: Prof. dr. Brikena Kadzadej-Zavalani, Prof. dr. Mario de Matteis, Prof. dr. Jörg Riecke, Prof. dr. Jürgen Röhling (Hrsg.), f. 147-158.

-Shadan Ramadani (2016): Die Merkmale der Literatur der Wende bei Albanischen Autoren (Shenjat e letërsisë së kthesës tek autorët shqiptarë). Në: Kadzadej, B. / de Mario M. / Riger – Coëdy (Hrsg.) (2016): Übersetzung, Literatur und Kultur als Brücken zur interkulturellen Kommunikation. Band 1. Tirana. f. 143-153.

-Shadan Ramadani (2017): Emigrantët shqiptarë në vendet gjermanisht-folëse si krijues letrarë dhe urëlidhëse kulturash. Në: Albanologjia, International Journal of Albanology, Vo. 4 / No 8, Tetova/ 2017, UDC: 81, ISSN 1857-9485. Editor-Chief: Vullnet Ameti, Editors: Salajdin Salihu, Fatmir Sulejmani. f. 113-123.

-Shadan Ramadani (2017): Reflektimi ndërkulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj: Analizë e teksteve mësimore (The intercultural reflection in lecturing German as a foreign language: Analysis of textbooks). Në: Proceedings book abstracts. Editors: Prof. Dr. İsmail GÜLEÇ Assoc. Prof. Dr. Adriatik DERJAJ Assoc. Prof. Dr. Bekir İNCE Assoc. Prof. Dr. Alpaslan OKUR. Online: <http://www.icotfl.sakarya.edu.tr/ep-content/uploads/%C3%B6zet-kitab%C4%B1-2.pdf>. f. 31.

-Shadan Ramadani (2017): The intercultural reflection in textbooks of German as a foreign language in Macedonia (Reflektimi ndërkulturor në tekstet mësimore të gjermanishtes si gjuhë e huaj në Maqedoni). Në: International magazine for social sciences "VISIONS" Shkup, Nr. 28/2017. Editor-in-chief Prof. Dr. Nazmi Maliqi. Online:

https://drive.google.com/file/d/0BxZD7QA_5LVLcldiX0h3U1JLY2s/view. f. 115-126.

Botime/Përkthime

- ALBANISCHE LITERATURSCHAFFENDE UND IHR BEITRAG ZUR DEUTSCH-ALBANISCHEN KULTUR Forschung albanischer Migranten zur Migrantenliteratur in den deutschsprachigen Ländern.

Hulumtime/Kërkime shkencore

- Punimi diplomës (1986): „Pranje koze-krzna“ (Universiteti i Zagrebit).

- Punimi diplomës (2010): „Literarische Vergangenheitsbewältigung in Deutschland nach 1945 anhand Heinrich Bölls *Der Mann mit den Messern* und Tanja Duckers *Himmelskörper*“ (Universiteti Shtetëror i Tetovës).

- Tema e Masterit (2013): „Albanische MigrantInnen als Literaturschaffende im deutschsprachigen Raum (Emigrantët shqiptarë si krijues letrarë në vendet gjermanofolëse)“ SEEU.

Disertacioni me titull *Reflektimi kulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Analizë e teksteve mësimore në sistemin shkollor në Maqedoni* merret me ndikimin e teksteve dhe të metodave të mëimit të gjuhës gjermane për rritjen e kompetencës së komunikimit ndërkulturor nëpër shkolla.

Në mënyrë më specifike, shpjegohet se si diskursi pedagogjik i këtyre teksteve ndihmon për të ndërtuar diferencat sociale dhe kulturore, nga ana tjetër sesi po i njëjti diskurs ndihmon për të zhvilluar më tej aftësimin e nxënësve dhe studentëve për menaxhimin e kompetencës ndërkulturore në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të kontribuojë në kuptueshmërinë e kompetencës së komunikimit ndërkulturor respektivisht reflektimit kulturor në tekstet mësimore dhe nëse përdorimi i saj gjatë mësimdhënies ndihmon në zhvillimin e aftësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës, por edhe në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive gjuhësore të nxënësve. Shpjegohet se problemet që vijnë nga praktikimi i komunikimit ndërkulturor mund të tejkalohen duke bërë një përshkrim dhe analizim të proceseve të komunikimit ndërkulturor, identifikimit të mënyrave jopajtuese të komunikimit, si dhe se problemet që rrjedhin prej tyre mund të parandalohen me anë të formave të ndryshme të trajnimit. Ndërsa nga ana teorike, theksohet se komunikimi

ndërkulturor paraqet një sfidë sepse është një fushë heterogjene, e cila nuk mund të studiohet e izoluar nga linguistët, por duhet parë nën prizmin e të folurit natyral, të jetuarit, informal dhe ashtu si jepet në realitet, dhe shpjegimet e kësaj dukurie duhet që të kërkohen në kornizën e teorisë së gjuhës, e cila është në gjendje që të përcaktojë nga ana socio- kulturore kuptimin dhe përdorimin. Mësimi modern komunikativ i gjuhës përfshin si ndërveprimin në grup ashtu dhe punën individuale në bazë të kurrikulumit mësimor dhe silabusit të çdo shkolle apo lënde. Poashtu pasqyron edhe mënyrën sesi nxënësit i perceptojnë aftësitë e tyre të kompetencës së komunikimit ndërkulturor dhe ndikimit nga faktorë të ndryshëm brenda kornizës së studimit të teksteve të mësimdhënies së gjuhës gjermane.

Përmendet se faktorët e brendshëm strukturorë dhe të formimit të sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë, po ndërthuren gjithnjë e më shumë me faktorë globalë të tillë si krijimi i profesioneve të reja, që nuk kanë ekzistuar më parë, mobiliteti në rritje dhe përzierja kulturore, e cila vjen jo vetëm nga përbërja e brendshme e popullsisë, por edhe nga format e reja të komunikimit, të marrëdhënieve midis njerëzve që ndikojnë në mënyrën e formimit të shoqërive të ndryshme në përgjithësi dhe atë të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në veçanti. Gjatë dekadave të fundit, njerëzit janë ndërgegjësuar gjithnjë e më shumë, meqenëse kontaktet ndërmjet tyre mund të ndikohen negativisht nga problemet e komunikimit, të cilat nuk mund të redukohen thjesht në mungesën e njohurive sa i përket theksit, gramatikës, apo leksikut të gjuhës së përdorur.

Në punim përshkruhet dhe shpjegohet teorikisht gjerë koncepti i kulturës dhe teorive të ndryshme rreth saj, në lidhje me linguistikën dhe socio-linguistikën ndërsa një vend qendror në këtë studim i është dhënë narrativave dhe shpjegimeve të teksteve mësimore në mënyrë që të kuptohen zgjedhjet racionale të tyre si pjesë e diskurit pedagogjik dhe sesi ky diskurs i trajton nxënësit dhe studentët gjatë procesit mësimor apo si ndikohen ata nga ky proces.

Ky punim përfshin gjithashtu një analizë të detajuar të përmbajtjes ndërkulturore në tekstet mësimore të gjuhës gjermane në Republikën e Maqedonisë. Pra, tekstet shihen edhe si subjekte të ndryshimit në sistemin arsimor.

Kandidati në këtë studim përqendrohet kryesisht në shpjegimin sesi zbatohet kompetenca e komunikimit ndërkulturor dhe sesi praktikohet ajo në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë, dhe sesi i ndihmon ky sistem përfshirjen dhe integrimin kulturor të nxënësve.

Kandidati vë theksin mbi rëndësinë dhe rolin që ka kompetenca e komunikimit ndërkulturor sot, jo vetëm në Republikën e Maqedonisë, por kudo në botë. Gjithashtu gjermanishtja si gjuhë e huaj është një ndër gjuhët më të kërkuara në Republikën e Maqedonisë për t'u mësuar nga nxënësit dhe studentët. Ajo nuk shërben vetëm për të afruar dhe ndërvepruar kulturën gjermane me kulturën vendore, por ndihmon në integrimin e kulturave dhe subkulturave edhe brenda vetë Republikës së Maqedonisë. Nga ana tjetër, ndryshe si dikur, konteksti kulturor gjatë mësimin të gjuhës është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm së bashku me kompetencën e komunikimit ndërkulturor në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Ndërkohë që roli i kompetencës së komunikimit ndërkulturor rritet, po ashtu paralelisht rritet dhe nevoja për të zbatuar metoda komunikimi ndërvepruese, të cilat zhdukin barrierat ndërmjet shkollës dhe komunitetit, personelit akademik dhe nxënësve etj.

Metodologjia e zgjedhur në këtë disertacion është e rëndësishme për këtë punim shkencor, ku bëhet një kombinim i metodave kërkimore duke u bazuar si në metodat sasiore ashtu edhe ato cilësore. Një vend të rëndësishëm zë analiza përshkruese dhe analizuese e teksteve duke u bazuar në paradigmen e kërkimit kritik për arsimin, e cila është e ndikuar nga studimet e hershme të autorit Jurgen Habermas dhe pasuesve të tij të Shkollës së Frankfurtit, ku ndër më të njohurit janë Adorno, Marcuse, Horkheimer dhe Fromm.

Metodat e përzgjedhura e kanë bërë të qartë dhe të kuptueshëm këtë punim shkencor.

Disertacioni i kandidatit Shadan Ramadanit është i ndarë në gjashtë kapituj kryesor, pjesën hyrëse dhe përfundimet.

Çështja e kompetencës së komunikimit ndërkulturor është një fushë shumë e gjerë dhe për këtë arsye nevojitet kufizimi në kohë dhe në hapësirë për të nxjerrë vlerësime dhe analiza sa më afër realitetit. Kjo gjë është bërë në kapitujt e parë, në të cilët është bërë një prezantim i qëllimeve dhe objektit të disertacionit së bashku me përkufizimin e koncepteve kryesore dhe delimitimin e tij.

Kapitulli i parë bën një përshkrim të shkurtër historik të mësimdhënies së gjuhës gjermane në Maqedoni dhe të rëndësisë së kësaj gjuhe nga këndvështrimi lokal. Si edhe një përshkrim të sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë, ndarjes dhe ndërveprimit midis niveleve horizontale dhe vertikale, dhe rolin që luan programi dhe qëllimet e silabuseve të gjuhës gjermane në këtë sistem. Pavarësisht studimeve të pakta të mëparshme, rëndësia e këtij kapitulli

është e madhe sepse është baza nga ku ngrihet edhe studimi kërkimor me pyetësor i zhvilluar në klasat e mësimit të gjuhës gjermane.

Kapitulli i dytë trajton nga ana teorike rolin dhe marrëdhënien e ngushtë që ekziston ndërmjet gjuhës dhe kulturës në mësime. Gjithashtu vend zë këtu roli që luan integrimi kulturor në mësime dhe kulturës së huaj. Një vëmendje gjithnjë e më të madhe po merr fakti se mësimi i gjuhës është aktiviteti gjuhësor, i cili është i lidhur me atë që individët komunikojnë ndërkohë që janë të angazhuar në një proces komunikues.

Kapitulli i tretë diskuton mbi problemet e mësimeve të kulturës gjatë mësimit të gjuhës së huaj si dhe teknikat dhe modelet e përdorura për ta integruar atë sa më mirë gjatë orës së mësimit. Është vlerësuar që keqkuptimet apo problemet gjatë mësimeve të kulturës dhe gjuhës së huaj janë një temë që është ngritur në shumë studime kërkimore, të cilat rezultojnë që situatat e konfliktit apo të përballjes shërbejnë dhe si mësim apo si mundësi për zhvillim, përderisa gabimet e paqëndrueshme të pjesëmarrësve në komunikim shërbejnë dhe për të rritur ndërgjegjësimin e tyre ndërmjet pjesëmarrësve apo thjesht si mësim për të mos përsëritur të njëjtat gabime.

Në kapitullin e katërt, kandidati shpjegon faktorët që ndikojnë në formimin e kompetencës së komunikimit ndërkulturor përsa i përket mësimeve të gjuhës së huaj. Theksohet se gjuha së bashku me kompetencën e komunikimit ndërkulturor kryejnë funksione mendore dhe paraqesin një formë në të cilën përmbajtja e kulturës materializohet duke transmetuar sisteme vlerash dhe një shumëfishim të identitetit kulturor. Mësimeve të gjuhëve të huaja dhe edukimi ndërkulturor kërkojnë një vëmendje gjithmonë më të madhe dhe një kujdes të vazhdueshëm ndaj çdo individi dhe ndaj çdo shoqërie të mundshme.

Gjithashtu pjesë e këtij kapitulli janë dhe dimensionet e kompetencës ndërkulturore dhe aspektet e përvetësimit. Mësimeve të gjuhëve të huaja dhe edukimi ndërkulturor kërkojnë një vëmendje gjithmonë më të madhe dhe një kujdes të vazhdueshëm ndaj çdo individi dhe ndaj çdo shoqërie të mundshme. Në procesin kompleks të komunikimit ndërkulturor shfaqen forma të ndryshme të integritit lingvistik dhe kulturor, duke filluar që nga përfaqësimet funksionale të përdorimit të strukturave lingvistike dhe të nevojshmërisë së përdorimit të regjistrave të ndryshëm gjuhësor, të roleve gjatë shkëmbimit të mesazheve zanore, dhe të konkurrencës në tregun e biznesit apo të punës. Sipas përdorimit specifik të gjuhëve është e rëndësishme që të integrojmë në një formë sa më të përshtatshme mësimin e gjuhëve, sipas edhe nevojave të nxënësve apo studentëve.

Në kapitullin e pestë, kandidati bën një prezantim të teksteve të përzgjedhura mësimore për hulumtim në sistemin shkollor. Përkatësisht janë tekstet e shkollës fillore: Planet 1 Deutsch für Jugendliche dhe Logisch A2 Deutsch für Jugendliche, shkolla e mesme: Prima A2/Band 4 Deutsch für Jugendliche, Beste Freunde B1/1 Deutsch für Jugendliche dhe Optimal B1 Lehrwerk für Deutsch als Fremdsprache. Tekstet mësimore që kandidati ka marrë në analizë duhet të nxisin komunikimin ndërkulturor nga pjesëmarrësit dhe supozohet se do të ndihmojnë në një kuptim më të mirë të popujve në shoqëritë multikulturore. Analiza është e fokusuar në elementet ndërkulturore që gjenden në tekstet mësimore që janë në treg dhe nëse po, në çfarë mënyre dhe çfarë intensiteti apo sasi janë ato. Kryesisht është vlerësuar se tekstet e përcaktuara dhe informacionet në këto tekste mësimore janë aktuale dhe të përshtatshme për grupmoshat të cilave ato iu drejtohen si dhe korrespondojnë me realitetin.

Ndërsa në kapitullin e gjashtë kandidati analizon tekstet mësimore në sistemin shkollor në Maqedoni. Ky analizim bëhet sipas komponentëve afektive, njohurive specifike kulturore, njohurive të përgjithshme mbi kulturën dhe komunikimin si dhe strategjive në „Planet 1, Logisch! A2, Prima A2/Band 4, Beste Freunde B1/1 dhe Optimal B1“. Gjithashtu ky kapitull përmban dhe rezultatet e fituara gjatë hulumtimit, si dhe jep propozime dhe këshilla didaktike dhe metodike. Në analizën e mësipërme të teksteve, ushtrimeve dhe shembujve, të cilat janë të pranishme në tekstet mësimore Planet 1, Logisch! A2, Prima A2/Band 4, Beste Freunde B1/1 dhe Optimal B1 është hulumtuar, se sa e nxisin dhe e zhvillojnë këto tekste mësimore të përzgjedhura reflektimin kulturor gjegjësisht kompetencën ndërkulturore. Ai është bazuar në modelin e kompetencës ndërkulturore të Knapp-Potthoff-it, i cili këtë kompetencë e ndanë në katër komponentë. Komponentë afektive, e cila përfaqësohet në forma të ndryshme në tekstet mësimore, ngërthen para së gjithash qëndrimet dhe vetitë e përgjithshme si aftësinë e empatisë, tolerancën përballë kulturës së huaj, interesimin për kulturën e huaj e tjera; njohuritë specifike të kulturës në promovimin e kompetencës ndërkulturore; njohuritë e përgjithshme mbi kulturën dhe komunikimin/vetëdije ndërkulturore e komunikimit si dhe strategjitë që promovojnë dhe stimulojnë kompetencën ndërkulturore të nxënësve.

Kandidati përsërit gjatë studimit, se tekstet vijnë duke kaluar në specifike kulturore me rritjen e nivelit shkollor. Pra tekstet për klasat më të ulta zakonisht përmbajnë informacione të përgjithshme që kanë të bëjnë më shumë me kulturën globale sesa me specifikat e kulturës gjermane. Më vonë tekstet e shkollës së mesme pasurohen me materiale specifike mbi kulturën,

gjeografinë dhe historinë gjermane. Në këtë mënyrë nxënësit apo studentët vetëm më vonë, gjatë adoleshencës arrijnë që të marrin informacione të plota kulturore. Ndërkohë, që ai mendon se diçka e tillë duhet të nisë më herët. Gjithashtu theksohet se tekstet mësimore duhet që të jenë dhe më të pasura me informacione kulturore duke qenë se shpeshherë kompetencës ndërkulturore i kushtohet vetëm një kapitull. Kjo gjë duhet bërë duke pasur parasysh dhe kontekstin e Republikës së Maqedonisë, i cili ka nevojë për zhvillimin e aftësive të kompetencës ndërkulturore. Kandidati më tej thekson se tekstet mësimore nuk duhet të përmbajnë gjeneralisime, meqenëse stereotipet mund të jenë të rrezikshme dhe të krijohen paragjykime, por ato duhet të ndërmjetësojnë heterogjenitetin dhe dinamikën kulturore.

Kapitujt e fundit përbëhen nga përfundimet, anekset e ndryshme të marra nga të dhënat empirike si dhe bibliografia. Ndërsa pjesët e tjera, hyrja dhe përfundimi i këtij disertacioni, kanë arritur të shpërfaqin shumë qartë dhe në mënyrë të detajuar objektivat, qëllimet dhe pritshmëritë e këtij punimi shkencor. Në pjesën e përfundimeve dhe rekomandimeve në këtë disertacion janë nxjerrë rezultatet dhe konstatimet gjatë kësaj pune shkencore për rolin dhe rëndësinë që kanë tekstet mësimore në shoqërinë tonë multikulturore dhe në globalizëm.

Përfundim dhe Propozim

Disertacioni i doktoraturës me titull: *Reflektimi kulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Analizë e teksteve mësimore në sistemin shkollor në Maqedoni (Kulturreflexives Lernen im Deutsch-als-Fremdsprache-Unterricht. Analyse von Lehrwerken im Schulbereich in Mazedonien)*, i kandidatit Shadan Ramadanit sjell një korpus të dendur vlerash. Së pari, ai sjell risi për fushën e shkencave metodike-pedagogjike, duke ndikuar shkencërisht te studiuesit e rinj dhe duke i motivuar ata për studime të mëtejshme; po ashtu ai ndikon në ngritjen e urave kulturore midis popullit gjerman dhe atij shqiptar.

Në këtë punim shkencor është bërë një punë përshkruuese dhe analizuese e qartë dhe me vlerë siç është fusha e mësimdhënies, por sidomos rëndësia e reflektimit kulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj në Republikën e Maqedonisë.

Përdorimi i gjetur i metodave adekuate mbi bazën e të cilave janë argumentuar të gjitha tezat dhe pyetjet kërkimore të ngritura nga ana e kandidatit dhe arritja e rezultateve dhe përfundimeve të sakta.

Në bazë të asaj që është thënë më sipër, Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: *Reflektimi kulturor në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Analizë e teksteve mësimore në sistemin shkollor në Maqedoni (Kulturreflexives Lernen im Deutsch-als-Fremdsprache-Unterricht. Analyse von Lehrwerken im Schulbereich in Mazedonien)*, i kandidatit Shadan Ramadanit, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret shkencore të përcaktuara dhe i propozon Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës që ta miratojë këtë raport dhe ta lejojë mbrojtjen publike.

Komisioni:

Prof. dr. Beate Henn-Memmesheimer, mentore

Prof. dr. Arbër Çeliku, kryetar

Prof.dr. Brikena Kadzadej, anëtare

Prof.dr. Lulzime Kamberi, anëtare

Prof.dr.Berton Sulejmani, anëtar

B. Henn-M.
A. Çeliku
B. Kadzadej
L. Kamberi
B. Sulejmani